

Shkëlqesi, kolegë dhe miq,

Është kënaqësi t'ju uroj mirëseardhjen të gjithëve sot në Prishtinë, në mes të një stine dimri pa dëborë – ilustrimi më i mirë se si po ndikon ndryshimi i klimës në jetën tonë. Më jep një kënaqësi të madhe të shoh këtu sot një sallë plotë, por edhe shumë pjesëmarrës online, me përfaqësues nga qeveritë e Ballkanit Perëndimor, rreth 20 donatorë dhe institucione financiare, 66 organizata ndërkombëtare, 45 kompani dhe më shumë se 50 përfaqësues nga shoqëria civile.

Jo rastësisht, ne filluam nga Prishtina serinë e kalendarit të ngjeshur të aktiviteteve, duke dedikuar energji dhe duke diskutuar së bashku për Agjendën e Gjellbër dhe Ekonominë Qarkulluese, dhe po ashtu lançimin e platformës mbi Ekonominë Qarkulluese. Tre vjet nga miratimi i Agjendës së Gjellbër të Ballkanit Perëndimor, tani është momenti i duhur **për të riafirmuar "aleancat tona të reformës" dhe "koalicionin tonë të vullnetshëm" - pasi zbatimi bën të nevojshëm një nexus të vërtetë mes Qeverive-BE-Sektorit Privat-Donatorë, - për të formësuar impaktin mjedisor të rajonit tonë, konkurrueshmërinë e ekonomive tona dhe së fundmi standardet e jetesës së qytetarëve tanë.**

Duke qenë se kjo është me të vërtetë një listë e gjatë, ky takim koordinues rajonal që po organizojmë së bashku me partnerët tanë - WBCIF dhe projektin EU4GREEN - do të jetë një platformë e rëndësishme:

- për të rinovuar angazhimet e nivelit të lartë të marra në kuadër të Agjendës së Gjellbër;
- për të nxitur një qendër rajonale të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive mbi Ekonominë Qarkulluese,
- dhe për të harmonizuar rrugët e financimit dhe për të zhbllokuar investimet e gjelbra.

Të nderuar,

Ndonëse duke u bërë një pikë e nxehtë për ndryshimet klimatike, rajoni ynë shpesh mund të përdorë lente miopike në mënyrë instinktive. Lente që ende nuk kapin me të vërtetë urgjencën dhe gjithëpërfshirjen e ndryshimeve klimatike dhe as, për shembull, normat e ulëta alarmante të riciklimit dhe mbetjet e larta në nivel lokal të krijuara për frymë!

Këto lente, sipas të dhënave të Barometrit tonë Ballkanik, tregojnë se vetëm 30% e bizneseve i shohin ndryshimet klimatike si problem për biznesin e tyre, ndërsa 43% besojnë se trazicioni i gjellbër nuk do ketë asnjë ndikim në biznesin e tyre, me 37% që nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të zvogëluar ndikimin në mjedis të biznesit të tyre. Fatkeqësisht, më shumë se një e treta e bizneseve (39%) nuk ndërmarrin asnjë aktivitet/iniciativë të ekonomisë qarkulluese. Shumica e bizneseve e konsiderojnë më lirë prodhimin e një produkti të ri se një produkti të ricikluar. Këto përqindje nuk do të na largojnë nga modelet lineare të përdorimit të burimeve!

Këto përqindje duken në **kontrast të fortë me përqindjet inkurajuese** që jam e sigurt se na kanë mbledhur të gjithëve sot këtu: strategjitë e ekonomisë qarkulluese mund të ulin emëtimet globale të gazrave serrë me 40%; të krijojnë 700,000 vende të reja pune vetëm në BE deri në vitin 2030, ose të

hapin një mundësi ekonomike prej 4.5 trilion dollarësh. Prandaj, ne kemi nevojë – për më shumë lente të orientuara drejt veprimit dhe më shumë të orientuara nga mundësitë midis të gjithë aktorëve kryesorë në zonë!

Të nderuar kolegë,

Duhet një fshat, siç thonë, dhe përpjekje kolektive, për të cilat të gjithë ne kemi një rol të rëndësishëm. Ato janë një domosdoshmëri për një rritje të qëndrueshme pakthim.

Angazhimi i **qeverive** ndaj tranzicionit në ekonominë qarkulluese, Agjenda e Gjelbër dhe përfundimisht tek Marrëveshja e Gjelbër Europiane dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm presupozon miratimin e politikave dhe kornizave rregullatore të fuqishme dhe mundësuese, së bashku me modele nxitëse për bizneset. Janë pikërisht bizneset tona ato që mbajnë barrën më të madhe të tranzicionit dhe kërkojnë mbështetje sistematike, në mënyrë që tranzicioni në ekonomi qarkulluese të ndjekë në të gjithë bordin e të gjithë aktorëve kryesorë ekonomikë. Ata gjithashtu mbajnë **një rol udhëheqës në përshejtimin e ekonomisë qarkulluese, me mbështetjen instrumentale financiare të shtrirë nga sektori financiar dhe komuniteti i donatorëve.**

Nëse shikojmë përmes lenteve të tyre, kufizimet kryesore për të ecur drejt modelit të ekonomisë qarkulluese janë:

- kosto shtesë për 49% të bizneseve,
- Mungesa e aftësive dhe ekspertizës (30%),
- mungesa e një kuadri rregullator (28%),
- mungesa e subvencioneve nga qeveria (29%)
- mungesa e kërkesës së konsumatorit (20%), sipas Balkan Barometer Business Opinion 2023.

Ekosistemi ynë i sipërmarrjes duhet të inojojë modele të reja biznesi, të cilat mbështeten në parimet e ripërdorimit dhe ndarjes. Edhe qytetarët kanë një kontribut të dukshëm nëpërmjet përqafimit të praktikave të qëndrueshme për “më shumë me më pak”.

Lista e gjatë e sfidave në këtë rrugë që përfshin financat dhe mungesën e aftësive, kufizimet e natyrshme të riciklimit, mundësitë kryesore ekonomike që mungojnë dhe shumë të tjera – është një **thirrje për bashkim të përpjekjeve!**

Të neglizhosh përqafimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese nuk është opsion, pasi paraqet rrezikun e ankorimit të rajonit në teknologjitë e vjetruara dhe intensive të karbonit. Ky qëndrim mund të dëmtojë konkurrencën e Ballkanit Perëndimor në tregun e përbashkët të BE-së.

Ne mund të "rrotullohemi rreth vetes" ose mund të përqafojmë me vendosmëri "rrethin e plotë" të vlerës së re dhe inovacionit!

Agjenda e Gjelbër duhet parë në dritën e **zhvillimit të vërtetë, rritjes dhe mundësive dhe të njihet përmes perspektivës pozitive që ka.** Agjenda e Gjelbër nuk mund të shihet vetëm nga perspektiva e kostos. Agjenda e Gjelbër mund të jetë një burim i rritjes thelbësore në rajon. Shembujt e fundit të zgjerimit masiv të kapaciteteve të burimeve të rinovueshme dhe ndërtimit të ndërlidhësve në pjesë të rajonit janë një hap në drejtimin e duhur. Rrugët e rëndësishme për rritjen e gjelbër qëndrojnë në

gjelbërimin e transportit dhe lëvizshmërisë sonë, duke investuar në efikasitetin e energjisë, duke u bazuar mbi vlerën e rinovimit të BE-së. Në gjelbërimin e vendeve të punës dhe investimeve.

Agjenda e Gjëlber është një nismë dinamike dhe në zhvillim që, si një organizëm i gjallë, kërkon përpjekje kolektive të sektorëve qeveritarë, privatë dhe joqeveritare **për të ushqyer, rritur dhe formësuar një plan të qëndrueshëm për të ardhmen.**

Takimi rajonal i sotëm në një sallë të mbushur plot dhe palët kryesore të interesit që ky takim bashkon dëshmojnë se jemi së bashku në drejtimin e duhur. Duke dhënë kontributin tonë të rëndësishëm dhe një hap drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Le të rrotullohemi për të evoluuar ose të zgjedhim të ripërdorim.